

VENDIM
Nr. 604, datë 5.9.2012

**PËR PROCEDURAT E VEPRIMIT TË SEKRETARIATIT TEKNIK PRANË KOMISIONIT
QEVERITAR TË TOKËS (KQT), PËR PËRCJELLJEN NË KQT TË ANKIMEVE NDAJ
VENDIMEVE TË KOMISIONEVE VENDORE TË VLERËSIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË
MBI TOKËN BUJQËSORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9/1 të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendimet e komisionit vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë (KV) për korrigjim, plotësim dhe rikonfirmim të aktit të marrjes së tokës në pronësi (AMTP), brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e tyre, u njoftohen subjektit të interesuar dhe komunës/bashkisë, nën juridiksionin territorial të së cilës ndodhet toka bujqësore, si dhe sekretariatit teknik pranë KQT-së. Njoftimi i shoqëruar me vendimin përkatës bëhet me postë apo çdo mënyrë të parashikuar në nenin 60 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

2. Subjekti i interesuar dhe komuna/bashkia përkatëse, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani e vendimit të KV-së, kanë të drejtë të paraqesin ankim ndaj këtij vendimi në KQT. Ankimi paraqitet në formë shkresore, i cili përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 143 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, dhe depozitohet pranë KV-së.

3. KV-ja mban një regjistër të veçantë për regjistrimin e ankimeve dhe duhet ta përcjellë ankimin në sekretariatin teknik pranë KQT-së, brenda 3 (tri) ditëve nga data e depozitimit të tij në KV. Asnjë ankim që paraqitet drejtpërdrejt nga subjekti i interesuar apo komuna/bashkia në sekretariatin teknik pranë KQT-së nuk do të pranohet për shqyrtim nëse nuk është regjistruar, brenda afatit ligjor të ankimit në KV-në përkatëse, dhe nuk dërgohet së bashku me dosjen përkatëse nga KV-ja.

4. Nëse subjekti i interesuar dhe komuna/bashkia nuk paraqesin ankim në KV, sipas afateve të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi, dhe sekretariati teknik gjen vendimin e KV-së në përputhje me ligjin, ai përgatit raportin përmbledhës për këto vendime, të cilin e paraqet në mbledhjen e radhës së KQT-së. Në rastet kur sekretariati teknik nuk ka informuar komisionin vendor për ndonjë parregullsi të vendimit, atëherë KV-ja brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e fundit e marrjes dijani të secilit prej subjekteve të interesuara, komunës/bashkisë, i jep vendimit formën përfundimtare.

5. Nëse subjekti i interesuar dhe komuna/bashkia përkatëse nuk paraqesin ankim, sipas afateve të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi, por sekretariati teknik nuk e gjen vendimin e KV-së në përputhje me ligjin, atëherë sekretariati teknik, brenda 10 (dhjetë) ditëve njofton KV-në për këtë dhe i kërkon dosjen e vendimit. Në këtë rast, KV-ja nuk i jep vendimit formën përfundimtare, por njofton subjektin e interesuar apo komunën/bashkinë për veprimet e sekretariatit teknik.

Sekretariati teknik shqyrton dosjen dhe përgatit raportin shpjegues për rregullshmërinë dhe ligjshmërinë e vendimit. Ky raport paraqitet në mbledhjen e radhës të KQT-së dhe përmban opinionin teknik e ligjor për vendimin. KQT-ja, në mbledhjen e radhës, shqyrton raportin e sekretariatit teknik dhe merr vendimin përkatës.

6. Në rastet kur subjekti i interesuar apo komuna/bashkia kanë paraqitur ankim pranë KV-së, sipas pikës 2 të këtij vendimi, sekretariati teknik, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e ankimit dhe dosjes përkatëse, përgatit raportin shpjegues për rregullshmërinë dhe ligjshmërinë e vendimit dhe e paraqet në mbledhjen e radhës të KQT-së. Në raportin e tij, sekretariati teknik paraqet edhe opinionin teknik e ligjor për zgjidhjen e ankimit nga KQT-ja, e cila në mbledhjen e radhës shqyrton raportin e sekretariatit teknik për vendimin dhe ankimin ndaj tij.

7. KQT-ja, në mbledhjen e radhës, pasi shqyrton raportin shpjegues për rregullshmërinë dhe ligjshmërinë e vendimeve të ankimeve, të hartuar nga sekretariati teknik dhe ankimin e subjektit të interesuar

apo të komunës/bashkisë, vendos:

a) lënien në fuqi të vendimit të KV-së dhe rrëzimin e ankimit, në rastet kur vendimi i KV-së është në përputhje me ligjin; ose

b) pranimin e ankimit, shfuqizimin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të tij; ose

c) pranimin e ankimit, shfuqizimin e vendimit dhe kthimin për rishqyrtim të tij pranë KV-së, duke evidentuar parregullsitë përkatëse.

8. Sekretariati teknik, brenda 7 (shtatë) ditëve zbardh vendimin e KQT-së, të cilin e nënshkruan kryetari i KQT-së dhe e vulos me vulën e Këshillit të Ministrave. Vendimi i KQT-së u njoftohet subjektit përfitues, komunës/bashkisë dhe KV-së, i shoqëruar me shkresë përcjellëse, të nënshkruar nga drejtori dhe të vulosur me vulën e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Në KV kthehet edhe dosja administrative e vendimit.

9. Kundër vendimit të KQT-së mund të bëhet ankim në Gjykatën e Tiranës nga subjekti i interesuar apo komuna/bashkia, sipas afateve dhe rregullave për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.

10. Ngarkohen Komisioni Qeveritar i Tokës, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha